



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 850/11 prot.

Datë 19.05.2026

V E N D I M

Nr. 670/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 478/2026, datë 08.04.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.

Ankimues: Operatori ekonomik “in Auto” SHPK me NIPT M31417021V me adresa: Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Tiranë

Operatori ekonomik “Anadea” SHPK me NUIS L87201401H dhe adresë: Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Lagjja Qendër, Rruga Nacionale Peshkopi – Tiranë, Bulqizë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Selenicë
Rruga “Llambi Bombaj”, Selenicë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 08.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 478/2026, ku vendosi:
[...]

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-73293-12-24-2025, me objekt: “BLERJE AUTOMJETE”, me fond limit 8,300,000.00 (tetë milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.*
2. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” shpk për procedurën e prokurimit të mësipërme.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “nAuto” SHPK.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 1406/13 prot., datë 14.05.2026 me lëndë “Kërkesë për heqje pezullimi”, protokolluar me tonën me nr. 850/8 prot., datë 18.05.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë, njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 478/2026, datë 08.04.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 1406/13 prot., datë 14.05.2026 me lëndë “Kërkesë për heqje pezullimi”, protokolluar me tonën me nr. 850/8 prot., datë 18.05.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë, njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 478/2026, datë 08.04.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.

II.2. Referuar shkresës me nr. 1336 prot., datë 08.04.2026, si dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin me nr. 478/2026, datë 08.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër arsyetuar autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 478/2026, datë 08.04.2026.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje Automjete” me Nr. REF-73293-12-24-2025, me fond limit: 8,300,000 (tetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

